



**REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ**

PLANI I PUNËS SË KABINETIT TË KRYETARIT TË KOMUNËS 2024

Rr: "Dëshmorët e Kombit" p.n - 70000 Ferizaj, Republika e Kosovës

E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net

Tel: 03820046049



PRIORITETET E PROGRAMIT QEVERISËS

- ⌘ MJEDISI
- ⌘ ZHVILLIMI EKONOMIK DHE BUJQËSIA
- ⌘ INFRASTRUKTURA DHE SHËRBIMET PUBLIKE
- ⌘ ARSIMI, KULTURA, RINIA DHE SPORTI, SIGURIA
- ⌘ SHËNDETËSIA DHE MIRËQENIA SOCIALE

Burimi:

<https://kk.rks-gov.net/ferizaj/wp-content/uploads/sites/31/2022/01/Platforma-Qeverisese.pdf>

Bazuar në këtë program, kemi marr besimin e qytetarëve për implementimin e tij në periudhën 2021-2025

KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS

NJËSITË NË KUADËR TË KABINETIT TË KRYETARIT TË KOMUNËS

- Zyra Ligjore
- Zyra e Informimit
- Zyra e Integriteteve Evropiane
- Zyra për Auditim të Brendshëm
- Zyra e Prokurimit
- Zyra e Personelit
- Zyra për Teknologji të Informacionit
- Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim
- Inspektorati i Komunës
- Njësia për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore

1. Zyra ligjore

Zyra ligjore e Komunës së Ferizajt është zyrë që sipas Statutit të Komunës bën pjesë në kuadër të zyrës së Kryetarit të Komunës së Ferizajt, e cila ka kompetencat e saj bazuar në rregullativën në fuqi.

Plani i Punës së Zyrës Ligjore të Komunës së Ferizajt është dokument i mbështetur në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Statutin e Komunës, dhe aktet tjera nënligjore.

Plani është i hartuar në bazë të një kornize logjike, i cili planifikon etapat e realizimit të punëve dhe detyrave të bazuara në detyrat dhe përgjegjësitë që dalin nga Ligji për Vetëqeverisje lokale, Statuti dhe aktet tjera nënligjore.

Me këtë plan synohet arritja e objektivave për vitin 2024, ku Zyra ligjore në Komunën e Ferizajt planifikon:

- Ofrimin e këshillave juridike të rregullta për organet komunale dhe trupave të formuara nga organet komunale, Kryetarin e Komunës, Kuvendin Komunal, drejtorët e drejtorive, komiteteve të përhershme dhe konsultative, Zyrës së Prokurimit, komisioneve komunale etj.)
- Harton (përpilon) vendime, aktvendime, pëlqime, urdhëresa, memorandume mirëkuptimi, kontrata, marrëveshje dhe shkresa të tjera për organet komunale dhe trupat e formuar nga organet komunale.
- Shqyrtimin paraprak të ligjshmërisë së rregulloreve komunale.
- Pjesëmarrjen në komisionet e ndryshme të formuara nga Kryetari i Komunës për çështjet e caktuara.
- Hartimin e rregulloreve sipas kërkesës së drejtorive.
- Pjesëmarrje të rregullt në përcjellje të seancave të Kuvendit të Komunës së Ferizajt.
- Përfaqësimin e Komunës së Ferizajt pranë organeve të tjera administrative dhe të drejtësisë.

2. Zyra për informim

- Zyra e Informimit në planin e saj të punës realizon aktivitetin e saj përmes:
- Publikimit të Vendimeve të nënshkruara nga Kryetari i Komunës
- Përgatitja e lajmeve dhe njoftimeve për aktivitetet e Kryetarit dhe drejtorive komunale.
- Dërgimi i vendimeve të nënshkruara nga Kryetari i Komunës në MAPL.
- Publikimi i raportit të qeverisë komunale
- Publikimi i planit të punës së qeverisë komunale
- Pranimi i kërkesave për qasje në dokumente publike dhe kthimi i përgjigjes bazuar në ligjin për qasje në dokumente publike
- Përgatitja e raportit për zyrën për Informim
- Pjesëmarrja nëpër takime të cilat kanë të bëjnë me transparencë dhe llogaridhënie
- Pranimi i kërkesave të OJQ-ve të ndryshme
- Përgatitja e njoftimeve për mbajtjen e debateve-konsultimeve publike me qytetarë
- Publikimi i njoftimeve për mbledhjet e kuvendit komunal-KPF-së dhe Komitetit për Komunitete si dhe komiteteve tjera konsultative.
- Përgatitja e njoftimeve për aktivitete përkujtimore, ngjarje e përvjetorë e për data të rëndësishme historike.
- Publikimi i broshurave të cilat janë në interes të informimit të qytetarëve.
- Publikimi i raportit njëvjeçar financiar
- Publikimi i dokumenteve si rregullore dhe plane të cilat duhet të dalin në diskutim publik me qytetarë
- Publikimi i raporteve të ndryshme
- Mbikqyrjen e zbatimit të Strategjisë Komunale të Komunikimit dhe Transparencës.
- Përgatitja e planit të veprimit për transparencë komunale

- Pjesëmarrja në takime-punëtori që lidhen me transparencë komunale
- Publikime të tjera, të dokumenteve zyrtare, materialeve zyrtare sipas detyrimeve ligjore dhe kërkesave në interes të publikut.

3. Zyra për Integritime Evropiane

Zyra për Integritime Evropiane funksionon në kuadër të Kabinetit të Kryetarit të Komunës së Ferizajt. Kjo zyre ka rol të koordinimit, monitorimit dhe raportimit në institucionet gjegjëse të cilat merren me Integritime Evropiane. Pra, linjat e komunikimit në mënyrë të vazhdueshme i mbajmë me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) dhe Ministrinë e Integritimit Evropian (MIE). ZIE bënë raportimin e rregullt periodik në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, lidhur me Bashkëpunimin Ndërkomunal dhe Komunal Ndërkombëtar. Poashtu kompletton dokumentacionin dhe dosjet e punëve të kryera. Zyra për Integritime Evropiane bënë Raportimin e rregullt në MAPL lidhur me implementimin e Planit Individual të Veprimit për Komunen e Ferizajt, dalur nga Agjenda Evropiane.

Në ZIE ndërmerren të gjitha ato veprime me prioritet për Integritimet Evropiane, me të cilën synohet të jetë krijimi i një klime të volitshme për përmirësimin e vazhdueshëm të kushteve të jetës së qytetarve, sundimin e ligjit, mbrojtjen e pronës, lirinë e lëvizjes, shprehjen e mendimit, tolerancën dhe krijimin e mirëbesimit.

Poashtu mbanë kontaktet e përditshme dhe dërgimin e informatave të kërkuara me Departamentin për Koordinim, Zhvillim dhe Integritime Evropiane të MAPL-së, Ministrinë për Integritime Evropiane dhe ministritë e linjave.

4. Zyra për Auditim të Brendshëm

Gjatë vitit 2024 Zyra e Auditimit të Brendshëm, sipas kërkesave specifike dhe detyrave të punës, planifikon të zhvilloj procedurat e auditimit në drejtoritë komunale dhe zyrat komunale, varësisht nga kërkesat dhe planifikimet paraprake, duke përfshirë këto drejtori dhe zyra komunale. auditohet këto Drejtori dhe Zyre:

- Drejtorinë e Administratës së Përgjithshme
- Drejtorinë e Financave
- Drejtorinë e Infrastrukturës
- Drejtorinë e Urbanizmit dhe Mjedisit
- Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenjes Sociale
- Drejtorinë e Arsimit
- Drejtorinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
- Drejtorinë e Bujqësisë dhe Pylltarisë
- Drejtorinë e Pronës, Katastrit dhe Gjeodezisë
- Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit
- Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave
- Zyrën e Personelit
- Zyrën e Prokurimit etj.

5. Zyra e Prokurimit

Plani i punës së Zyrës së Prokurimit është i ndikuar nga planet e punës së drejtorive komunale. Përmes këtij plani synim i zyrës së prokurimit është që të kryej të gjitha veprimet me kohë, pa vonesa duke u bazuar në planifikimet e drejtorive komunale për projektet kapitale dhe në pajtim me ligjin e prokurimit publik. Detajet e Planit Vjetor të Prokurimit, janë të publikuara në uebfaqen e Komunës.

6. Zyra e Personelit

Zyra e Personelit në kuadër të kompetencave të saj, për periudhën deri në fund të vitit 2024, ka për synim të arrij këto objektiva:

- Mbajtjen e nivelit të efektivitetit të shërbimeve të Njesisë së Personelit
- Implementimin e ndryshimeve të reja ligjore në fushën e resurseve njerëzore
- Implementimi dhe familjarizimin e punëtorëve dhe menaxhmentit me programin SIMBNJ
- Monitorimin e prezencës së punëtorëve në punë
- Përkujdesjen për pajisjen e punëtorëve me kartela identifikimi
- Menaxhimi efikas me arkivin e Njesisë së personelit

7. Zyra për Teknologji të Informacionit

- Do të sigurohemi, se të gjithë zyrtarët dhe drejtorët e drejtorive të jenë të pajisur me pajisje të nevojshme për punë administrative në zyrë, me e-mail zyrtar për të gjithë stafin dhe drejtorët e drejtorive, po ashtu edhe për anëtarët e Kuvendit të Komunës.
- Shfrytëzimi racional dhe suportimi i stafit në aktivizim të Intranetit.
- Përditësimi dhe plotësimi i UEB-faqes së Komunës së Ferizajt me të gjitha informatat, vendimet, urdhëresat, në mënyrë që transparenca ta ketë fjalën kryesore. Poashtu, do të vendoset një monitor në hapësirën e administratës së komunës, ku do të publikohen informata me rëndësi nga lajmet ditore dhe shpenzimet financiare nga qeverisja komunale.

8. Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim

Në planin e punës për periudhën janar – dhjetor 2024, përfshihen aktivitetet që do të realizohen në fushën e përfaqësimit të komuniteteve joshumicë dhe politikave për kthimin e qëndrueshëm.

Përmbajtja e përfshirë në planin njëvjeçar të cilin po e prezantojmë është bazuar edhe në statistikën e grumbulluar nga bashkëpunëtorët relevant, me të cilët ZKKK është në kontakt të vazhdueshëm dhe ka një shkëmbim dhe bashkëpunim të frytshëm, veçmas me Drejtorinë e Arsimit dhe atë të Shëndetësisë/QPS-në, Policinë dhe të tjerët. Nuk do të mungoj bashkëpunimi me zyrtarë të zyrës së Avokatit të Popullit.

I tërë plani nënvizon rëndësinë e nxitjes së koordinimit dhe rritjes së bashkëpunimit me të gjithë akterët e përfshirë në çështjet e përfaqësimit dhe avancimit të të drejtave të komuniteteve joshumicë me qëllim të angazhimit në hartimin e politikave të qëndrueshme komunale me fokus mbrojtjen e të drejtave të njeriut në përgjithësi.

ZKKK në Komunën e Ferizajt është e angazhuar sipas legjislacionit në fuqi edhe me politikën e programet e saj të specializuara edhe në fushën e ri-integrimit të personave të riatdhesuar.

9. Inspektorati i Komunës

Me qëllim të ushtrimit të funksioneve të përcaktuara me dispozitat ligjore në fuqi, Sektori i Inspeksionit përbehet nga:

1. Inspeksioni i Tregut;
2. Inspeksioni i Ndërtimitarisë;
3. Inspeksioni i Mbrojtjes së mjedisit;
4. Inspeksioni Komunal (Shërbimeve Komunale)

Objektivi i sektorit për Inspektime në Komunën e Ferizajt është mbikëqyrja dhe inspektimi i të gjitha dukurive negative që hasen në territorin e Komunës së Ferizajt.

- Mbikëqyrjen dhe aplikimin e ligjeve dhe akteve tjera ligjore në fushën e ndërtimit, tregut, mbrojtjes së ambientit, Shërbimeve komunale etj.
- Kontrolle subjekteve afariste të cilat operojnë në Komunën e Ferizajt;
- Organizimin, kontrollimin dhe respektimit të orarit të punës nga subjektet afariste, kontrolli mbi të dhënat e prejardhjes së mallit, kontrolli i vulosjes (kalibrimi) së peshoreve, përcjelljen e subjekteve afariste që kanë sjellje monopoliste për të mos lejuar konkurrencën jo lojale në treg, konfiskimin e mallit në përputhje me dispozitat ligjor mbi tregtinë në rastet kur malli është pa dokumentacion përcjellës, pa faturë, pa dërgesë, pa numër të regjistrimit të biznesit dhe të blerësit, pa regjistrimin e faturës dhe kur subjekti afarist nuk ka leje, mbrojtja e konsumatorit, si dhe shqyrtimin i ankesave të ardhura nga Departamenti i mbrojtjes së konsumatorit.
- Inspektimi dokumentacionin teknik (projektet e ndërtimit, lejet e ndërtimit, inspektimin final të vendndërtimit);
- Inspektimi i procesit të ndërtimeve në të gjitha fazat dhe verifikimi me përputhshmërinë dhe dokumentacionin ndërtimor.
- Monitorimi i ndotjes nga djegjet e thëngjillit, plastikës si dhe sendeve tjera të cilat ndotin ambientin e të cilat nuk lejohen të digjen.
- Identifikimi i deponive eventuale ilegale të cilat mund të krijohen si dhe marrja e të gjitha masave për largimin e tyre. Inspektimi i hapësirave publike, afër ndërtimeve lidhur me ndotjen e rrugëve, si dhe ndikimin e tyre në ndotjen e mjedisit.
- Ofrimi i këshillave dhe udhëzime lidhur me përmirësimin e gjendjes për një ambient sa më të pastërt.
- Mbrojtja e hapësirave publike nga shfrytëzimi eventual në mënyrë të paligjshme dhe pa leje nga organi kompetent. Largimi i shitësve ambulant nga sheshet dhe parqet e qytetit në përputhje me rregulloren komunale në fuqi.
- Identifikimi i personave dhe subjekteve që mund ta dëmtojnë rrugët, trotuarin, apo rrjetin e kanalizimit pa lejen e organit kompetent.
- Përcjellë rrjetin e ujës-jellësit, kyçjet pa leje në rrjet, si dhe parandalimin e keqpërdorimit të ujit të pijshëm.

- Ekzekuton vendimet, përcjell, evidenton dhe ndërmerr masa ligjore ndaj subjekteve-operatorëve që kryejnë veprimtari joligjore nga kompetenca e Sektorit;
- Përgatitë aksione konkrete për eliminimin e të metave që paraqiten në raste konkrete në bashkëveprim me organet tjera kompetente si dhe bashkëvepron me subjektet shtetërore si: Policia, Gjykata, Prokuroria, etj.;
- Të kryejë detyrat dhe përgjegjësitë në bashkëpunim të ngushtë me drejtoritë tjera të Komunës.

10. Njësia për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore

- Ndërmerr të gjitha masat e nevojshme për të vlerësuar dhe siguruar përputhshmerin e politikave, legjislacionit dhe aktivitetet e Komunës me standartet e larta për të drejtat e njeriut.
- Mbështet dhe ofron këshilla dhe sipas kërkesës për udhëheqësin më të lartë administrativ të institucionit dhe titullarin e institucionit për fushën e përgjegjësisë që udhëheqë;
- Zbaton Ligjet, Planet dhe Strategjit e miratuara nga Qeveria dhe Kuvendi i Republikës së Kosovës.
- Bashkëpunon dhe koordinon aktivitete me strukturat e nivelit komunal, duke caktuar nga një zyrtar i cili do të jetë person kontaktues që do të veproj si nderlidhje nëmes NJDNJK, strukturave komunale dhe QJQ në sferen e mbrojtjes dhe promovimit të drejtave të njeriut.
- Bashkëpunon me insticucionet dhe Agjencionet e jashtme duke përfshirë edhe institucionin e Ombudspersonit në republikën e Kosovës.
- Bashkëpunon dhe shkëmben informata në qdo drejtori dhe njësi brenda komunë si dhe me mekanizma tjerë relevant për të drejtat e njeriut në nivel komunal dhe qendror.
- Bënë vlersimin e nevojave për ngritjen e kapaciteteve në fushën e të drejtave të njeriut në komunë.
- Kryen edhe detyra të tjera sipas kërkesave të eprorit.